

NE JEMI DEMOKRACIA

LORIK (11), ARD (11), ELFINA (11), LORENË (11), ERIOLA (11), TRINGA (11)



Demokrati, ti o sistemi më i mirë për të cilin unë kam mësuar dhe kam dëgjuar ndonjëherë. Të drejtohem ty o perëndeshë e sistemeve të udhëheqjes. Ty, që na bërë të mundur të gjithë qytetarëve të trajtohem në mënyrë të barabartë, të shprehemi lirshëm dhe t'i gëzojmë të gjitha të mirat që emri yt ngërthen në vete

Pasditja jonë e sotme filloi pak më ndryshe se zakonisht për grupin tonë, duke përfshirë këtu edhe veten time. Filluam diskutimin për disa nga të drejtat tona që i gëzojmë në vendin tonë. Sipas Ardilit, një nga të drejtat themelore që fëmijët e kanë është e drejta e familjes. Por, për të vazhduar edhe më tej, shoqja Elфина mendoi që përpos të drejtës së familjes, edhe e drejta e arsimit është e drejtë themelore dhe rëndësia e saj veç sa vjen e rritet.

“Edukimi është baza dhe çelësi i një të ardhme të ndritur dhe i një vendi sa më të zhvilluar,” tha Elфина. E kështu, vazhduam diskutimin në grup, secili duke shprehur mendimet lirshëm. Përpos këtyre të drejtave që përmenden shokët, Eriola tha që është e rëndësishme të flasim pak edhe për përgjegjësitë. Kjo sepse ashtu siç i gëzojmë këto të drejta, ne kemi edhe përgjegjësi ndaj tyre. Për shembull, për të drejtën e familjes që e kemi cekur më lart, përgjegjësi e kemi që t'i respektojmë dhe t'i duam të gjithë anëtarët e familjes. Ose për të drejtën e arsimit, përgjegjësi kemi që të mësojmë. Pra, nuk mund të kemi vetëm të drejta e të mos kemi përgjegjësi. Pasi pothuajse i gjithë grupi shpreh mendimet, Loriku tha që është e papranueshme të mos flasim pak edhe për barazinë. Sepse sipas tij çdo qytetar është dhe duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë me të tjerët. Për çudi, Tringa filloi të vështronte nga shoku Lorik, dhe e pyeti atë: “A ekziston ndonjë


sistem i qeverisjes ku të gjithë qytetarët trajtohen të barabartë?,” Loriku iu përgjigj kështu: “Pa dyshim që ekziston, e ai sistem njihet si demokraci.” Nëse nuk e keni dëgjuar më parë, fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke “demos,” që do të thotë popull dhe “kratos,” që do të thotë qeverisje. E tërë kjo i bie që demokracia është udhëheqje e popullit. Pra, ajo nuk qenka udhëheqje e disa personave, por qenka udhëheqje e të gjithëve. “Siç po e shihni, demokracia është barazi,” e përmbylli Loriku. Tringa pastaj u kthye nga grupi e tha: “Oh, sa e lumtur jam që sot e kuptova mirë rëndësinë e demokracisë. Demokraci, ti je bekim për ne qytetarët,” e përmbylli Tringa. E unë, Lorena dua të shtoj një fakt tjetër për demokracinë. Ekziston demokracia e drejtpërdrejtë dhe ajo përfaqësuese. Nga këto dyja, vendi ynë ka demokraci përfaqësuese.



Pjesëmarrja dhe angazhimi ynë për artikullin e demokracisë

ZBATIMI I LIGJEVE

DORART (12), ANDI (11), EMIR (11), ERISA (11), DENISA (11), FLANDRA (12)




Të gjitha ligjet miratohen ose nuk miratohen në Kuvend, prandaj njëri nga funksionet kryesore është funksioni legjislativ. Ligjet mund t'i propozojnë deputetët, Qeveria, Presidenti apo qytetarët. Këta të fundit duhet të mbledhin të paktën 10.000 nënshkrime, në mënyrë që të merret parasysh propozimi i tyre

Kuvendi, institucioni më demokratik i vendit. Për ta kuptuar sesa është i rëndësishëm Kuvendi, iu ftojme që ta lexoni artikullin tonë

Ne si fëmijë i kemi të drejtat tona. Për shkak që jetojmë në një vend demokratik, këto të drejta i kemi të garantuara me ligj. Ligjet janë rregulla, të cilat ne duhet t'i respektojmë dhe t'i zbatojmë. Edhe pse e kemi të drejtën e lojës, ne duhet të bashkëpunojmë me njërin-tjetrin dhe të kemi respekt gjatë lojës.

E kemi të drejtën e kujdesit shëndetësor, por paraprakisht duhet të kujdesemi vetë për shëndetin tonë. Kjo arrihet duke bërë ushtrime, duke ngrënë ushqim të shëndetshëm dhe duke e mbajtur ambientin e pastër. Ne, gjithashtu, nuk duhet të hedhim mbeturina dhe duhet të mbjellim edhe pemë të gjelbëruara. Pra, të gjitha të mirat që na i ofron demokracia, duhet të mundohemi që t'i përdorim për qëllime të mira. Jo vetëm për veten tonë, por për të mirën e të gjithëve.


Ligjet të cilat i përmendëm më lart, miratohen në Kuvend, i cili njihet edhe si „Vendi i ligjeve“. Deputetët të cilët na përfaqësojnë neve, marrin vendime të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë të cilët i zgjedh populli. 100 prej tyre janë deputetë të kombit shqiptar dhe 20 të tjerë janë nga komunitetet jo shumicë. Në demokraci ka barazi, prandaj edhe komunitetet e tjera kanë të drejtat e barabarta me të gjithë të tjerët.




Në Kuvend mbahen seancat plenare, të cilat janë mbledhjet e deputetëve me Qeverinë. Aty diskutohen çështje të ndryshme dhe shumë të rëndësishme për vendin



Grupi "Deputetët e ardhshëm,,"




Qytetarët në demokraci kanë shumë të drejta. Disa nga to janë: e drejta e shprehjes së lirë, e votës, e shkollimit, etj




Duke mësuar ne e ndërtojmë demokracinë. Të jemi sa më aktiv në shkollë

Gjatë Punëtorisë së Demokracisë, ne kemi qenë në rolin e gazetarit. Prandaj, si gazetarë të mirë, kemi punuar shumë dhe secili nga ne ka pasur detyrat e veta dhe të ndara në grupe të vogla. Në këtë pjesë të gazetës sonë, ju të dashur lexues, mund të gjeni disa nga vizatimet e punuara nga ne. Me shumë dashuri dhe

përkushtim jemi munduar që edhe ju lexues të kësaj gazete, të mësoni më shumë për demokracinë përmes vizatimeve tona. Ne ndihemi shumë krenarë për rolin që kemi pasur dhe mendojmë se e kemi kryer detyrën tonë siç duhet. Secili nga ne ka dhënë kontributin e vet dhe si rezultat, kemi krijuar këtë gazetë të këndshme.





Në të kaluarën, gratë kanë pasur më pak të drejta. Mirëpo, kjo ka ndryshuar. Sot të gjithë jemi të barabartë



Sot kuptuam se vota është zëri ynë. Andaj, gjithmonë duhet ta shprehim mendimin tonë përmes votës

RËNDËSIA E VOTËS

DRENUSHË (11), LORESA (10), ERODITA (11), MBRESLINDA (12), ERBLIN (11), LEART (11), SHPAT (11)



Vota është vërtet e rëndësishme. Për ta kuptuar pse, mos u ndalni së lexuari artikullin tonë

Unë dhe grupi im kemi vendosur të ndajmë një histori me ju. Përmes kësaj historie, do të kuptoni shumë për procesin zgjedhor.



Atëherë, të dashur, procesi zgjedhor është procesi më i rëndësishëm demokratik. Në këtë proces, të gjithë qytetarët e mbajnë një përgjegjësi të madhe mbi supë. Ata zgjedhin udhëheqësit apo përfaqësuesit e vendit. Mirëpo, kush merr pjesë në këtë proces? Në këtë proces, marrin pjesë të gjithë personat mbi moshën 18 vjeçare. Historia jonë fillon këtu. Unë dhe shoqet e mia kemi arritur moshën 18 vjeçare, këtë vit. Andaj, edhe kemi marrë pjesë në zgjedhjet lokale që u mbajtën në tetor. Kur shkua të votonim, edhe shoqja jonë Rea, e cila është një vajzë me nevoja të veçanta, ishte me

ne. Ajo sikurse edhe ne, ka votuar pa asnjë problem. A e dini çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë *barazi*. Të drejtën e votës e gëzojmë të gjithë, pa asnjë dallim. A nuk është bukur kur të jemi të gjithë të barabartë? Në demokraci nuk ka dallime racore, kombëtare, fetare apo dallime të tjera. Kjo është demokracia jonë. Një kopsht i bukur me lule, ku të gjithë jetojmë të lumtur në të dhe nuhasim aromat më të këndshme të këtij kopshti.

Lexues të dashur, kemi dy lloje të zgjedhjeve. Janë zgjedhjet komunale (lokale), ku ne i zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse dhe asamblistët e komunës. Si dhe zgjedhjet qendrore (parlamentare), ku i zgjedhim përfaqësuesit tanë, deputetët



Autorët punëtorë dhe demokratikë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Halil Alidema“
Klasa: VI-3
Vendi: Pozheran, Viti